



02/Nr. 9071 /2018
Data: 29.10. 2018

PROCESVERBAL I KKSBB-së

Nga mbledhja e dhjetë - X- për vitin 2018 mbajtur me datë: 26.10.2018 me fillim pune në ora 14:00, prezent ishin: **Muhedin Çaka dhe Besnik Mulaku** (përfaqësues të stacionit policor), **Vahid Hyseni** (përfaqësues i policisë kufitare –vija e gjelbër), **Menduh Vlasi** (përfaqësues i drejtorisë për arsim, kulturë, rinë dhe sport), **Ali Vishi** (përfaqësues i FSK-së), **Refet Kalisi** (përfaqësues i drejtorisë për shërbime publike dhe emergjencë), **Isni Bushi** (përfaqësues i këshillit të prindërve), **Nustret Shiti** (përfaqësues i këshillit të bashkësisë islame në Han të Elezit), **Qamil Kalisi** (përfaqësues i Hendikosit).
Bashkim Sopa (zyrtar për informim).

Takimin e kryesoj kryetari i komunës z. **Rufki Suma**.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë mbi sigurinë në komunën e Hanit të Elezit.
3. Të ndryshme.

Rufki Suma pasi përshëndeti të pranishmit lexoi rendin e punës dhe pasi që nga të pranishmit nuk pati vërejtje në rendin e punës, njëzëri u miratua rendi i punës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Rufki Suma a keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit.

Vahid Hyseni vërejtje nuk kam, mirëpo a ekziston mundësia që me na u dërguar më herët procesverbali.

Rufki Suma a keni edhe ndonjë diskutim, nëse nuk ka të gjithë jemi në dakord që procesverbali me u dërguar më herët te anëtarët e KKSBB-së. Procesverbalin nga mbledhja e kaluar e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Miratohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

2. Informatë mbi sigurinë në komunën e Hanit të Elezit.

Rufki Suma lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Muhedin Çaka gjatë këtij muaji kemi pas 5 (pesë) raste. Situata e sigurisë ishte e qetë gjatë këtij.

Nustret Shiti gjatë bisedave që kam me persona të ndryshëm ankohen se në Han të Elezit po përdoren substanca të ndryshme narkotike.

Muhedin Çaka ju sugjerojë që të lajmëroni rastet e narkotikëve në stacion policorë sepse luftën më të madhe që do ta kemi ne si shtete është për droga, se është bërë njëjtë numri i rasteve të drogave me atë të vjedhjeve. Është mirë me i plasuar informatat të cilat i keni për shkak se çdo informatë që jepet është e rëndësishme për policinë.

Vahid Hyseni gjatë këtij muaji kemi pas 4 (katër) raste. Rasti më i veçantë është i konfiskimit të substancës narkotike në vendin e quajtur Ura e Gurit. Është mirë që të gjithë të angazhohemi dhe të punojmë se pasojat mund të jenë për të gjithë. Situata e sigurisë ishte e qetë gjatë këtij muaji.

Rufki Suma a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka si vlerësim i përgjithshëm është se gjendja e sigurisë në komunën e Hanit të Elezit është e mirë.

3. Të ndryshme.

Rufki Suma kompanisë “Bektelenka” ja kemi ndërprerë punimet pas orës 23:00 për shkak të ankesave që kemi pasur nga qytetarët. Kompania ka premtuar që do ty kryen disa projekte për komunën e Hanit të Elezit por nuk i ka kryer. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Vahid Hyseni pala Maqedone është ankuar se gjoja në vendin e quajtur Llokme që pjesa e tyre njihet si Bilak, banorët e fshatit Paldenicë po i presin Drutë. Është mirë që të diskutohet me qytetarë dhe të ju sugjerohet që mos me dal në pjesën e Maqedonisë.

Rufki Suma a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në ora 14: 40 ju faleminderit për pjesëmarrje.

Procesmbajtësi
Ayni Bushi

